



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 26/09/2023
Nr. 5/2863

Komisioni për licencimin e BPrAL / kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 12, 13 dhe neni 14 pika 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037, në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5 me nr. protokoll 2963 të datës 25.07.2023 si dhe kërkesën nr.2963 datë 11.08.2023 të parashtruar nga BPrAL - kolegji "UNIVERSUM" për ndryshim të emrit nga kolegji "UNIVERSUM" në "UNI – UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE" në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 20.09.2023 mori këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa nr. 5 protokoll 2963 të datës 25.07.2023 si dhe kërkesën nr.2963 datë 11.08.2023 e BPrAL- kolegjit "UNIVERSUM"
2. Nga emri kolegji "UNIVERSUM" tani e tutje ky institucion do të ketë emër të ri dhe quhet : "UNI – UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE".
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr.5 me protokoll 2963 të datës 25.07.2023 si dhe kërkesën nr.2963 datë 11.08.2023, të parashtruar nga BPrAL -kolegji "UNIVERSUM" për ndryshim të emrit nga kolegji "UNIVERSUM" në "UNI – UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE" vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore, prandaj kërkesa e atij institucioni aprovohet.

Duke u mbështetur në dokumentin (në gjuhë angleze) e datës 21.03.2023, nënshkruar ndërmjet kolegjit "UNIVERSUM" dhe "ARIZONA STATE UNIVERSITY UNI UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE" si dhe dokumentacionin tjetër të kompletuar (në gj. shqipe):
1) Shtojca e Diplomës; 2) Transkriptë, Vërtetim, Memo; 3) Vula; 4). Vendimi për shtim të emrit

tregtar 5). Certifikata e Re e Biznesit – ARBK, 6). Vendimi i Licencimit, të dorëzuar në MASHTI, Komisionin për Licencim e ka cilësuar këtë fakt si e arritur e madhe nga ana e këtij institucioni privat, por jo vetëm kaq, atëherë pasi shqyrtoi në plotëni materialin e ofruar vendosi ta aprovoj kërkesën ashtu që ky kolegji privat tani e tutje do të ketë emrin e ri : “ **UNI – UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE**” dhe veprimtarinë e vet arsimore dhe hulumtuese do ta zhvilloj nën këtë emërtim- gjithashtu, duke përfshirë edhe dokumentacionin e vet.

Komisioni për licencim i MASHTI, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit


Burim Gashi